



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Nr. 15/2 Prot.

Tiranë, më 07.03. 2025

VENDIM

Nr. 97, Datë 07.03.2025

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit (komisioni) në mbledhjen e tij të datës 07.03.2025 ku morën pjesë:

- | | |
|-------------------------|----------|
| - Znj. Arsiola Dyrmishi | Kryetare |
| - Z. Gentjan Thoma | Anëtar |
| - Znj. Anairda Arizaj | Anëtare |
| - Znj. Ersida Teliti | Anëtare |

vijoi shqyrtimin e ankesës së konsumatores A.H kundrejt subjektit tregtar “Zayainalbania” (faqe online).

Komisioni pasi dëgjoi informacionin e përgatitur nga Sekretariati teknik dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij,

VËREN SE:

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë, nëpërmjet shkresës nr.11510, datë 24.12.2024, ka përcjellë pranë komisionit ankesës e konsumatores A.H kundrejt subjektit tregtar “Zayainalbania” (faqe online).

Ankesa është administruar pranë komisionit me numër protokolli 97, datë 31.12.2024.

Konsumatorja A.H. ka porositur në faqen online të subjektit tregtar “Zayainalbania” 3 produkte, por në momentin e marrjes së porosisë ka konstatuar se njëri prej produkteve mungonte, megjithëse pagesa ishte bërë për të tre produktet e porositur. Menjëherë konsumatorja ka kontaktuar me subjektin tregtar nëpërmjet faqes online për mungesën e produktit, ku i është premtuar se do ti dërgohej, por megjithë komunikimet e vazhdueshme nuk i është dërguar produkti i munguar.

Në këto kushte, fillimisht konsumatorja A.H. i është drejtuar me ankesë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, e cila në vijim e ka përcjellë ankesën pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit nëpërmjet shkresës nr.11510, datë 24.12.2024 (protokolluar pranë komisionit me nr.97 datë 31.12.2024).

- **Lidhur me kompetencën e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit**

Së pari, subjekti “Zayainalbania” zhvillon aktivitet tregtar nëpërmjet faqes së saj në rrjetin social Instagram.

Në kuptim të përkufizimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 e ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar, subjekti plotëson kërkesat ligjore për t’u klasifikuar si “tregtar”, pasi është subjekt, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike dhe/ose tregtinë.

Së dyti, çështja është objekt shqyrtimi, pasi konsiston në një marrëdhënie midis tregtarit dhe konsumatorëve dhe rrjedhimisht brenda fushës së zbatimit të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar dhe në kompetencë të Komisionit.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se, shqyrtimi i ankesës së lartpërmendur është në kompetencë të saj.

Bazuar në VKM-në nr.1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”, pika 3, shkronja (a) parashikon se:

“3. Komisioni ka përgjegjësinë të shqyrtojë shkeljet e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, për:
a) praktikën e padrejta tregtare”.

- **Vlerësimi i praktikës**

Komisionit i është përcjellë nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Tiranë ankesa e konsumatores A.H. kundrejt subjektit tregtar “Zayainalbania” (faqe online). Në mbledhjen e datës 15.01.2025, Komisioni vendosi fillimin e hetimit administrativ për subjektin tregtar “Zayainalbania” (faqe online). Me anë të shkresës me nr.97/1, datë 31.01.2025 i është bërë me dije subjektit tregtar “Zayainalbania” (faqe online) se pranë komisionit është përcjellë ankesa e konsumtares së sipërcituar dhe nga ana e komisionit ka filluar hetimi administrativ, si dhe është kërkuar që brenda datës 14 shkurt 2025 të dërgohet një informacion i plotë sqarues dhe dokumentacion si nga shoqëria edhe nga konsumtarorja në lidhje me sa pretendohet prej kësaj të fundit. Shkresa nr.97/1, datë 31.01.2025 i është dërguar subjektit tregtar “Zayainalbania” dhe konsumatores A.H. në rrugë elektronike me email-in e datës 04.02.2025.

Komisioni në mbledhjen e datës 07.03.2025, mori në shqyrtim përgjigjen e ardhur në vijim të shkresës së saj nr.97/1, datë 31.01.2025 nga ana e konsumatores A.H. e cila me email-in e datës 05.02.2025 informon se nga ana e subjektit tregtar i është dërguar produkti i munguar, shoqëruar me kuponin tatimor dhe në këto kushte nga ana e konsumatores është kërkuar tërheqja e ankesës së bërë nga ana e saj.

Për sa më sipër, në kushtet kur konsumatorja ka konfirmuar se nga ana e subjektit tregtar i është dërguar produkti i munguar, komisioni konsideron se mosmarrëveshja është zgjidhur mes palëve dhe nuk ka arsye ligjore për të vijuar më tej procedurën e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, mbështetur në nenin 52, të Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, dhe në pikën 2, të VKM-së nr.1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”,

VENDOSI:

1. Pushimin e hetimit administrativ të nisur kundrejt subjektit tregtar “Zayainalbania” (faqe online).
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Kundër këtij vendimi keni të drejtë të ankoheni në gjykatën kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETARI KOMISIONIT

ARSIOLA DYRMISHI

